



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 12.12.2025

Numër Protokolli: 8089/2025

A.nr.1426/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1426/2025, të datës 22.07.2025, të parashtruar nga ankuesit: I.B, R.K, A.B, Sh.H dhe L.B, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Klinaku & Associates L.L.C”, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 12.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1426/2025, e datës 22.07.2025, e parashtruar nga ankuesit I.B, R.K, A.B, Sh.H dhe L.B.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Ref.DS-461/2025, i datës 11.07.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, I.B, R.K, A.B, Sh.H dhe L.B (tutje referuar: Ankuesit), më datë 18.07.2025, përmes postës së Kosovës kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 22.07.2025, kundër Vendimi Ref.DS-461/2025, të datës 11.07.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tutje referuar SKGJK*), ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4875/2025, të parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre Shoqëria e Avokatëve “Klinaku & Associates L.L.C”, më datë 18.07.2025, Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë

22.07.2025; Autorizimin për përfaqësim; Formularin e parashtrimit të ankesës; Plikon e datës 18.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Akt emërimit me referencë: DS-675/2024, të datës 01.07.2024; Akt emërimit me referencë DS-679, të datës 01.07.2024; Akt emërimit me referencë DS-700/2024, të datës 01.07.2024; Akt emërimit me referencë DS-678/2024, të datës 01.07.2024; Akt emërimit me referencë DS-673/2024, të datës 01.07.2025; Vendimi Ref.DS-461/2025, i datës 11.07.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën e ankuesve të datës 03.07.2025; Listën e pagave për muajin Janar 2024; Listën e pagave për muajin Shkurt 2024; Listën e pagave për muajin Korrik 2024; Listën e pagave për muajin Shtator 2024; Listën e pagave për muajin tetor 2024; Listën e pagave për muajin dhjetor 2024; Listën e pagave për muajin Shkurt 2025; Listën e pagave për muajin Mars 2025; Listën e pagave për muajin Prill 2025, Listën e pagave për muajin Gusht 2025; Vendimin për shtyerjen e afatit nga Kryetari i Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të çështjes rezulton se ankuesit janë të punësuar në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës del se ankuesit më datë 03.07.2025, përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e Avokatëve “Klinaku & Associates L.L.C”, kanë parashtruar kërkesë me numër protokolli Nr.1155 pranë organit të punësimit, gjegjësisht Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar kompensimin e përvojës së punës nga 0.25% në 0.50%, nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit për Paga në Sektorin Publik, ndërsa, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Vendimin me numër reference Ref.DS-461/2025, të datës 11.07.2025, ka refuzuar kërkesën e ankuesve të datës 03.07.2025.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kërkojnë aprovimin e ankesës së tyre dhe të detyrohet SKGJK-ja që të bëjë kompensimin për vlerën sipas përvojës së punës nga 0.25% tani e tutje në 0.5% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik dhe në vazhdimësi.

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të diapozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para*

të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas sqarimeve të Gjykatës Kushtetuese, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj ligjshmërinë e pretendimit ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë, kështu që, pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore, ndërsa, mbi këto konstatime, Vendimi Ref.DS-i numër reference Ref.DS-461/2025, i datës 11.07.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së është i drejtë dhe i ligjshëm.

Andaj theksuar si më sipër, si dhe bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1426/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve *Shoqëria e Avokatëve "Klinaku & Associates L.L.C"*;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.